



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**RAPORT VJETOR
PËRMBLEDHËS PËR
VLERËSIMIN E CILËSISË NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË
HUAJA**

**Viti akademik
2023-2024**

LISTA E SHKURTESAVE

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

NJSBC - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

GVB – Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

1. HYRJE

Baza ligjore, konteksti dhe qëllimi i raportit

Ky raport vjen në kuadër të politikave të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në dokumentet e mëposhtme:

1. Ligji nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (neni 6, 33, 38, 46, 87, 98, 99, 103, 104);
2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, VKM nr. 531, datë 11.9.2018, Shtojca nr. 2, 3 dhe 4
3. Statuti i UT-së, 2018;
4. Rregullore e UT-së, 2022;
5. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë e UT-së, 2020;
6. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT, 2022;
7. Manuali i cilësisë në UT;
8. Paketa e instrumenteve të cilësisë, 2020;
9. Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, 2022.

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore dhe ato bazë të FGJH për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe të programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Raporti paraqet të dhëna domethënëse për vitin akademik 2023-2024 të cilat janë tregues për cilësinë e veprimtarive akademike në FGJH si dhe të dhënat e përfutuara nga anketimet e kryera në të njëjtin vit akademik për të dy ciklet e studimit, për të gjithë departamentet e FGJH-së të përmbledhura në raportet vjetore të cilësisë të njësive bazë në FGJH.

Analiza dhe rekomandimet në mbyllje të raportit synojnë orientimin e veprimtarive në vazhdim për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.

2. ZHVILLIME NË KURRIKULAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 23 - 24

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja nëpërmjet programeve të tij synon përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës, në shërbim të zhvillimeve

dinamike në nivel kombëtar, rajonal, dhe evropian, duke ofruar një mjedis bashkëpunues që transmeton dhe zhvillon dijet nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Duke pasur parasysh dhe në vëmendje dinamikat e zhvillimeve më të fundit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka si mision ofrimin e programeve mësimore konkurruese bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikula bashkëkohore, orientimin e studentëve drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për tregun e punës.

2.1. ZHVILLIME NË KURRIKULAT CIKLI I PARË I STUDIMEVE:

Programet e studimit “Bachelor” që ofrohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës janë organizuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe në mbështetje të Strategjisë së UT-së.

Programi i studimit Bachelor realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja e tij normale është tre vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare Bachelor në gjuhët dhe profilet përkatëse të studimit. Programet Bachelor ofrohen në lidhje me fusha si mësimdhënia, përkthimi, studime gjuhësore, letrare dhe kulturore, të cilat kanë për qëllim të formojnë specialistë të cilët aftësohen për të shërbyer në sektorin publik e privat. Studentëve gjithashtu u ofrohet mundësia për të vijuar studime të thelluara në fushat e komunikimit, përkthimit e mësimdhënies. Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe të ofrimit të programeve të reja studimore, si dhe në mbështetje të neneve 70-71 të ligjit Nr. 80/2015 dhe neneve 46-47 të Statutit të UT-së, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është në procesin e miratimit nga MAS për programet e reja të studimit si më poshtë:

- “Bachelor në Gjuhë dhe Kulturë Frënge dhe Kineze” në bashkëpunim me Universitetin Bejing, Kinë.
- “Bachelor në Gjuhë angleze me profil në Marrëdhënie me publikun” në bashkëpunim me Universitetin e Kaunas, Lituani.

2.2. ZHVILLIME NË KURRIKULAT CIKLI E DYTË TË STUDIMEVE

Në lidhje me programet Master, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si edhe me Udhëzimin Nr.1., datë 14.01.2020, *"Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë,"* Kreu IV *"Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit"*, Statutin e UT-së 2018, Neni 105.

Dhe në zbatim të vendimi të MAS “Për përafrimin e programeve të Mësuesisë në rang Republike”, Fakulteti i Gjuhëve të huaja ka aplikuar për riorganizim mbi masën 20% të shprehur në kredite të programeve studimore si më poshtë:

1. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Angleze
2. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Frënge
3. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Italiane
4. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Gjermane
5. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Turke
6. Master i Shkencave në Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Greke

si dhe për hapjen e një programit të ri Master i Shkencave në “Mësuesi Gjuhë e huaj, Gjuhë Spanjolle”.

Programet e studimit janë organizuar në mënyrë të kujdesshme duke harmonizuar të gjithë komponentët përbërëse dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019).

Në drejtim të garantimit të cilësisë dhe të njohjes së programeve të ofruara prej tij Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka aplikuar për akreditim pranë ASCAL dhe është në procesin e akreditimit për programet e studimit të ciklit të dytë si në vijim:

1. Master i shkencave në Përkthim Teknik – Letrar dhe Interpretim;
2. Master i Shkencave në Mësuesi e Gjuhës Turke për arsimin e mesëm të lartë, për vitet akademike 2021-2023 dhe ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe është në pritje të grupit të ekspertëve në institucion në muajin dhjetor 2024.

2.3. ZHVILLIME NË KURRIKULAT CIKLI E TRETË TË STUDIMEVE

Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” dhe synon të nxisë kërkimin shkencor në një fushë të caktuar për të sjellë risi në mendimin shkencor dhe prurje me interes dhe dobi shoqërore.

2.3.1. Aktivitetet e zhvilluara:

Aktivitete shkencore 23-24 : konferenca, seminare, forume shkencore, tavolina të rrumbullakëta, workshope:

- 5 konferenca : ndërkombëtare dhe kombëtare

- 226 seminare, work shope, forume shkencore, tavolina të rrumbullakta, ditë studimore.

3. LIDHJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME TREGUN E PUNËS

Programeve të studimit të ofruara nga FGJH-ja janë të hartuara bazuar në kompetenca (bazë të fushës/profesionale), të cilave u korrespondojnë rezultatet dhe aftësitë përkatëse të të nxënit që synojnë aftësimin vetjak dhe organizimit të pavarur, aftësimin shoqëror dhe komunikues, njohuri bazë të gjuhëve të studimit, njohuri rreth letërsisë, kulturës dhe historisë së vendeve gjuhën e së cilës studiojnë, aftësim për të kryer kërkim për çështje gjuhësore, letrare e kulturore, njohuri rreth çështjeve si komunikim ndërkulturor, kompetencë ndërkulturore, takime kulturore, mësimdhënie, përkthim dhe interpretim sipas profileve të studimit.

Gjatë vitit 2024, FGJH ka kryer analizën e tregut të punës për të diplomuarit për vitin 2023. Për realizimin e këtij studimi janë përdorur disa mjete si analiza e të dhënave statistikore për tregun e punës në sektorin mësuesisë, statistika marrë sipas burimeve zyrtare për punësimin e përkthyesve në tregun vendas; pyetësor me aktorët kryesorë (agjencitë dhe operatorët) turistikë vendas; të dhëna të tregut për ofruesit e arsimit mbi turizmin; pyetësor me studentët e diplomuar nga FGJH; si dhe analizë e të dhënave statistikore sipas burimeve zyrtare, për tregun e punës në sektorin e turizmit.

4. VLERËSIMI NGA STUDENTËT (Pyetësori “Vlerësimi për lëndën dhe pedagogun nga studenti” SHTOJCA NR. 1)

Gjatë vitit akademik 2023-2024 është bërë vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorit “Vlerësimi i lëndës dhe pedagogut nga studentët”, i ndarë në dy semestra, dy javë para çdo sezoni provimesh për ciklin e parë, Bachelor. Metodologjia e studimit është sasiore dhe cilësore. Pyetësorët e zhvilluar janë hartuar në përputhje me paketën e instrumenteve të cilësisë e miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 51 datë 23.12.2020. Kryerja e vlerësimit studentor për cilësinë e mësimdhënies përcaktohet në Rregulloren për sigurimin e cilësisë në UT (neni 26, germa h), dhe zhvillohet në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve.

Pyetësori përbëhet nga 9 pyetje të shtrira në seksionet kryesore:

1. Përmbajtjen dhe organizimin e lëndës
2. Infrastruktura
3. Mjedis i të nxënit dhe metodat e mësimdhënies

4. Burimet e të nxënit
5. Vlerësimi
6. Pedagogu
7. Detyrat

Studenti i përgjigjet pyetjeve sipas vlerësimit individual si në vijim:

- Plotësisht dakord
- Dakord
- Nuk e di
- Kundër.

Gjithashtu, pas çdo pyetjeje në alternativën Komento studentët kishin mundësi të jepnin mendimin e tyre në lidhje me lëndën, mësimdhënien dhe pedagogun.

Hartimi dhe shpërndarja e pyetësorëve u krye nga Zyra e cilësisë në bashkëpunim me NJSBC FGJH dhe me NJSBC e njësive bazë. Rezultatet e pyetësorëve u mbledhën në mënyrë elektronike nga formati Teams Forms, u përpunuan në formatin Excel nga zyra e Cilësisë dhe e Kurrikulës dhe iu përcollën drejtuesit të njësive bazë. Pas marrjes së rezultateve, drejtuesi i njësive bazë i shpërndau ato individualisht tek secili anëtar i njësive bazë dhe në vijim organizoi një mbledhje ku u analizua dhe diskutua në lidhje me rezultatet e pyetësorëve dhe me masat që duhen ndërmarrë.

Në vijim paraqiten përqindjet dhe analiza për secilin seksion dhe pyetje në nivel fakulteti semestri, pasi ato në nivel njësie trajtohen, dhe analizohen në departamentet përkatëse dhe NJSBC e njësive bazë hartojnë raportet e tyre për çdo njësi, raporte që më pas arkivohen dhe i përcillen NJSBC Kryesore.

Në vijim paraqiten përqindjet dhe analiza për secilin seksion dhe pyetje në nivel fakulteti semestri 1 (parë):

Cilësia në përmbajtjen dhe organizimin e lëndës

Pyetjet	TOTAL FGJH			
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Unë mendoj se lënda ishte strukturuar mirë për të arritur rezultatet e të nxënit (balancim i mirë ndërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve, detyrave dhe konsultimeve etj).	60%	32%	6%	3%
2. Metodat e të nxënit dhe të mësimdhënies nxisin pjesëmarrjen	58%	33%	5%	4%
3. Objektivat e lëndës, Idetë dhe konceptet e marra ishin të qarta	60%	31%	6%	3%
4. Ngarkesa e lëndës ishte e përballueshme	44%	45%	7%	3%

Raport Vjetor për Vlerësimin e Cilësisë në FGJH 23 - 24

5. Lënda nxiste interesin për fushën e studimit	54%	36%	6%	4%
---	-----	-----	----	----

Mjedisi dhe burimet e të nxënit

Pyetjet	TOTAL FGJH			
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Materialet mësimore (teksti, leksionet e shtypura, materialet ndihmëse për lëndën etj.) ishin të përshtatshme dhe të dobishme	61%	33%	4%	2%
2. Librat e rekomanduar ishin të rëndësishëm dhe të përshtatshëm.	57%	33%	5%	3%
3. Ofrimi i burimeve të të nxënit në bibliotekë ishte i mjaftueshëm	50%	36%	11%	3%
4. Ofrimi i burimeve të të nxënit në Internet ishte i mjaftueshëm.	55%	36%	7%	3%
5. Auditorët kishin logjistikën dhe kushtet e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	56%	36%	5%	3%

Vlerësimi

Pyetjet	TOTAL FGJH			
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Detyrat ishin të dobishme.	59%	34%	4%	2%
2. Unë isha i/e kënaqur me sasinë e punës së pavarur që kërkohej për kryerjen e detyrave.	57%	35%	5%	3%
3. Pedagogu na udhëzonte për kryerjen e detyrave.	64%	31%	3%	2%
4. Komentet e marra për vlerësimin e detyrave ishin të dobishme.	59%	34%	5%	2%
1. Metodatat e vlerësimit ishin të ndryshme dhe të përshtatshme.	57%	36%	5%	3%
2. Rezultatet e vlerësimit jepën në kohë.	61%	31%	6%	3%
3. Vlerësimi është i drejtë dhe transparent.	64%	28%	6%	2%

Pedagogu

Pyetjet	TOTAL FGJH			
---------	------------	--	--	--

Raport Vjetor për Vlerësimin e Cilësisë në FGJH 23 - 24

	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Pedagogu zotëron përmbajtjen e lëndës	68%	26%	4%	2%
2. Pedagogu përdor metoda të ndryshme mësimdhënie	58%	33%	5%	4%
3. Pedagogu e shpjegon lëndën në mënyrë të qartë dhe të efektshme.	64%	28%	5%	3%
4. Pedagogu i përgjigjet pyetjeve, nevojave dhe kërkesave të studentëve.	67%	27%	4%	2%
5. Pedagogu ndërvepron në mënyrë efikase me studentët (p.sh. njoftimet për ndryshime, dhënia në kohë e materialeve, etj.)	64%	30%	4%	3%
6. Pedagogu krijon një atmosferë që favorizon të nxënit në auditor.	62%	31%	5%	3%
7. Pedagogu tregon respekt ndaj studentëve dhe nxit pjesëmarrjen në mësim.	68%	26%	4%	3%

Vlerësimi përfundimtar

Pyetjet	TOTAL FGJH			
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
	100%	75%	50%	25%
1. Unë jam aktivizuar gjatë lëndës.	36%	58%	19%	7%
2. Unë mendoj se kam përparuar në këtë lëndë.	34%	38%	21%	8%

Në vijim paraqiten përqindjet dhe analiza për secilin seksion dhe pyetje në nivel fakulteti semestri 2 (dytë):

Cilësia në përmbajtjen dhe organizimin e lëndës

Pyetjet	TOTAL FGJH			
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Lënda paraqet një strukturim të mirë lidhur me raportin ndërmjet;leksioneve/seminareve/laboratorëve/detyrave/konsultimeve etj.	74%	22%	3%	1%

Raport Vjetor për Vlerësimin e Cilësisë në FGJH 23 - 24

2. Lënda ofron larmi veprimtarish motivuese dhe nxitëse dhe burimesh informacioni.	73%	22%	3%	2%
3. Lënda ofron përmbajtje dhe nivel vështirësie të përshtatshëm për formimin e studentit.	71%	24%	3%	2%

Mjedisi dhe burimet e të nxënit

Pyetjet		TOTAL FGJH		
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Burimet e bibliotekës kanë qenë të mjaftueshme dhe më kanë shërbyer në studimet dhe kërkimet e mia për lëndën.	66%	25%	6%	3%

Vlerësimi

Pyetjet		TOTAL FGJH		
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër
1. Vlerësimi i lëndës është kryer me metoda të ndryshme e në raportin e duhur ndërmjet: provimeve, detyrave të kursit, projekteve, aktivizimit në klasë.	72%	23%	3%	2%
2. Vlerësimi i vazhduar gjatë gjithë kursit ka qenë i dobishëm për progresin tim në këtë lëndë	71%	23%	4%	2%
3. Vlerësimi i lëndës ka qenë i drejtë dhe transparent	74%	22%	3%	1%

Pedagogu

Pyetjet		TOTAL FGJH		
	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk e di	Kundër

1. Pedagogu përdor teknologjitë e nevojshme (burimet në ueb, tabelat ndërvepruese, platforma online, etj) për ta bërë mësimin tërheqës dhe të qartë.	73%	22%	3%	2%
2. Pedagogu respekton rregulloren e programit, të etikës, ndërveprimit dhe marrëdhënieve reciproke pedagog - student	73%	22%	3%	2%

Strukturimi i Lëndës: Rreth 74% e studentëve janë plotësisht dakord se lënda paraqet një strukturim të mirë lidhur me raportin ndërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve, detyrave dhe konsultimeve, duke krijuar një përvojë mësimore të balancuar.

Larmia e Veprimtarive: 73% e studentëve vlerësojnë që lënda ofron larmi veprimtarish motivuese dhe burimesh informacioni, duke e bërë mësimin më tërheqës dhe stimulues.

Niveli i Vështirësisë: 71% e studentëve besojnë se lënda ofron përmbajtje dhe nivel vështirësie të përshtatshëm për formimin e tyre, duke mbështetur zhvillimin e tyre akademik.

Burimet e Bibliotekës: 66% e studentëve janë plotësisht dakord se burimet e bibliotekës kanë qenë të mjaftueshme dhe kanë ndihmuar ndjeshëm në studimet dhe kërkimet e tyre.

Procesi i Vlerësimit: 72% e studentëve janë plotësisht dakord se vlerësimi i lëndës është kryer me metoda të ndryshme dhe në raportin e duhur ndërmjet provimeve, detyrave të kursit, projekteve dhe aktivizimit në klasë. Vlerësimi është perceptuar si i drejtë dhe transparent nga 74% e studentëve.

Përdorimi i Teknologjisë: 73% e studentëve janë plotësisht dakord se pedagogët përdorin teknologjitë e nevojshme për ta bërë mësimin tërheqës dhe të qartë.

Përfundimet

1. **Përmirësimi i Procesit Mësimor:** Rezultatet e pyetësorëve tregojnë një kënaqësi të lartë të studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, qartësinë e objektivave të mësimdhënies, dhe metodat e organizimit të mësimin. Studentët vlerësojnë pozitivisht vlerësimin, mundësitë e ndërveprimit me pedagogët dhe cilësinë e shpjegimeve.

2. **Angazhimi i Pedagogëve:** Pedagogët janë vlerësuar për përgatitjen dhe angazhimin e tyre, si dhe për aftësinë për të krijuar një atmosferë pozitive dhe stimuluese në auditor, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe mësimin interaktiv.
3. **Metodat e Vlerësimit dhe Burimet Mësimore:** Metodat e ndryshme të vlerësimit, përfshirë seminarët interaktive, detyrat e rregullta dhe projektet, janë vlerësuar pozitivisht. Studentët janë të kënaqur me burimet mësimore të ofruara dhe mundësitë për hulumtim.
4. **Marrëdhënia me Pedagogët:** Studentët kanë shprehur kënaqësi të lartë për marrëdhënien me pedagogët dhe për mundësitë për të marrë komente të dobishme lidhur me performancën akademike.

Rekomandimet:

1. **Promovimi i Bibliotekave dhe Burimeve Online:** Duhet të promovohet përdorimi më i shpeshtë i bibliotekave dhe burimeve online për të ndihmuar studentët në zhvillimin e njohurive të tyre.
2. **Përmirësimi i strukturimit të testeve dhe hartimi i mirëekuilibruar i pyetjeve:** Sugjerohet përmirësimi i mënyrës së formulimit të pyetjeve në provime për t'i bërë ato më të qarta dhe të drejtpërdrejta, si dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive gjatë seminareve.
3. **Përdorimi i Teknologjisë në Mësimdhënie:** Studentët kanë kërkuar përdorimin më të shpeshtë të tabelave interaktive dhe mjeteve teknologjike në lëndët praktike për të pasuruar përvojën mësimore.
4. **Informimi me efikas** lidhur me atë përqindje shumë të vogël studentësh që në përgjigjet e tyre rezultojnë që nuk dinë se si të përgjigjen. Kjo implikon njësitë përkatëse dhe personelin akademik përkatës për të ofruar informacionet e nevojshme lidhur me lëndën dhe aspekte të ndryshme të saj.

Pyetësi “Vlerësimi për lëndën dhe pedagogun nga studenti” SHTOJCA NR. 1

Pyetjet	Shumë i kënaqur	I kënaqur	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Lënda paraqet një strukturim të mirë lidhur me raportin ndërmjet: leksioneve/seminareve/laboratorëve/detyrave/konsultimeve etj.				
Lënda ofron larmi veprimtarish motivuese dhe nxitëse dhe burimesh informacioni.				
Lënda ofron përmbajtje dhe nivel vështirësie të përshtatshëm për formimin e studentit.				
Pedagogu përdor teknologjitë e nevojshme(burimet në ueb,tabelat ndërvepruese,platforma online, etj) për ta bërë mësimin tërheqës dhe të qartë.				
Pedagogu respekton rregulloren e programit, të etikës, ndërveprimet dhe marrëdhëniet reciproke pedagog - student.				
Burimet e bibliotekës kanë qenë të mjaftueshme dhe më kanë shërbyer në studimet dhe kërkimet e mia për lëndën.				
Vlerësimi i lëndës është kryer me metoda të ndryshme e në raportin e duhur ndërmjet: provimeve, detyrave të kursit, projekteve, aktivizimit në klasë.				
Vlerësimi i vazhduar gjatë gjithë kursit ka qenë i dobishëm për progresin tim në këtë lëndë.				
Vlerësimi i lëndës ka qenë i drejtë dhe transparent.				
Komente dhe sugjerime				